

Editorial/

I PARI STUDIM NË SHQIPËRI MBI DISKRIMINIMIN E VAJZAVE ME SHAMI

Nga Ada Kocani



Synimi i këtij studimi ishte që të trajtonte në nivel kërkimor problemet që lidhen me mbulimin e femrave në shoqërinë aktuale shqiptare. Një studim i tillë ishte i nevojshëm, sepse deri tani nuk ekzistonte një i ngjashëm me të, ndërkohë që problemet e lidhura me mbulimin e femrave në shoqërinë shqiptare janë të pranishme dhe për to ka mjaft spekulime të bazuara thjesht në opinione dhe paragjyqime. Jo rallë këto probleme shfaqen edhe në trajta ekstreme të konflikteve sociale. Kështu, për shembull, janë ndaluar që të ndjekin shkollën vajza të mbuluara me pretendimin se shkollat publike janë laike, ose me pretendimin se këto vajza në ciklin nëntëvjeçar dhe të mesëm janë të vogla kështu që manipulohen ose detyrohen nga familja për t'u mbuluar.

Në rastet kur flitet, diskutohet ose merren vendime për çështje që kanë të bëjnë me femrat e mbuluara, ajo që ka munguar më së shumti është zëri i këtyre femrave. Të njëjtën gjë ka evidentuar edhe studiuesja Joan Scott në librin e saj "The Politics of the Veil" (Politika e ferexhese), për rastin francez ku në debatet për çështjen e vajzave me shami "ajo që ka munguar është zëri i vetë vajzave".

Flasin të tjerët në emër të saj, duke pretenduar se ajo që thonë është në të mirë të shoqërisë dhe të vetë këtyre vajzave, duke pretenduar se

po i mbrojnë këto vajza, qoftë edhe nga vetja e tyre (kur pretendohet që janë të vogla e gabojnë), ose duke pretenduar që po i ndihmojnë të emancipohen (kur pretendohet se janë mbuluar nga injoranca). Por a e dinë ata se çfarë duan këto femra, çfarë kërkojnë dhe çfarë mendojnë ato? Si rrjedhojë është e nevojshme të sillt një studim ku të kuptohet gjendja e tyre nëpërmjet asaj që ato thonë.

Përkëtë arsye bëhet domosdoshme që të hidhet dritë në nivel studimor lidhur me shkaqet dhe rrugët e zgjidhjes së këtyre problemeve që kanë të bëjnë me mbulimin e femrave.

Në opinionin e gjerë shqiptar është përhapur idea se femrat shqiptare mbulohen me detyrim dhe për këtë shfrytëzohet kryesisht mosha e tyre e vogël dhe mos dija e tyre. Pra e paraqesin dukurinë e mbulimit të femrave shqiptare si një farë manipulimi dhe detyrimi dhe aspak si një akt të kryer me vullnet të lirë prej tyre. Kjo ide e tipit paragjykim (sepse nuk ka dalë si përfundim logjik i një gjykimi studimor të problemit) është parapëlqyer si një farë argumenti nga të gjithë ata persona që kanë mbështetur veprimet e moslejimit arbitrar të nxënësve apo studenteve të mbuluara në mjediset e shkollave publike. Gjithashtu ky paragjykim paraqitet në media nga të ashtëquajturit analist, si realiteti absolut i çështjes së mbulimit në

Shqipëri, dhe asnjëri prej këtyre "analistëve" nuk paraqit ndonjë të dhënë ose studim, ose statistike ku bazon atë që pretendon.

Shkaqet e qëndrimeve të tilla në shoqërinë shqiptare janë të thella dhe lidhen sa me shfaqjen e dukurisë së islamofobisë, aq edhe me paragjykimet më të herëshme islamofobike në trajtën e të ashtuquajturit "orientalizëm". Është e njohur që në vizionin dihotomik të orientalizmit gjithshka pozitive polarizohet në "botën perëndimore", kurse gjithshka negative - në atë lindore (në "orient"). Përkrahësit e këtij vizioni "orientalist", sidomos në periudhën post komuniste, kanë dalë hapur me qëndrimet e tyre kundër islamizmit dhe qytetërimit osman, duke përdorur "penelatat më të errëta" për të përshkruar periudhën e

pushtimit gati 5 shekullor otoman të Shqipërisë. (Këtë fenomen e sqaron më së miri studiuesi E. Sulstarova në librin e tij "Arratisje nga lindja")

Për këto arsye që lidhen sa me qëndrimet në përgjithësi islamofobike, aq edhe me ato në veçanti kundër mbulimit të femrave muslimane, bëhet e domosdoshme që të hidhet dritë në nivel studimor edhe për shkaqet dhe rrugët e zgjidhjes së problemeve që kanë të bëjnë me mbulimin e femrave.

Studimi u bazua në rezultatet e dala nga një anketim me 248 femra të mbuluara, në xhamitë kryesore të Tiranës, në Qendrën Studentore "Vizioni i Ri", në Institutin e Gjuhës Arabe dhe shkollën 9 vjeçare dhe të mesme "Qëllimi i Jetës".

(Vijon në faqen 3...)

LETËR NGUSHËLLIMI

I nderuar Ambasador i Republikës së Turqisë, z. Hidayet Bayraktar!

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë e ka përjetuar me dhimbje lajmin për tragjedinë që ndodhi në minierën e qymyrit në Soma të Turqisë, në të cilën humbën jetën qindra minatorë, e shumë të tjerë u plagosën.

Ne, si shqiptarë dhe besimtarë muslimanë, i lutemi Allahut të Madhëruar për shpirtat e atyre që humbën jetën, që Ai t'i përfshijë ata në mëshirën e Tij dhe t'u japë familjarëve dhe popullit vëlla turk, kurajë dhe durim në këto momente të vështira për të gjithë ju.

Bashkohemi me ju në dhimbjen dhe lutjet tuaja dhe shprehim ndjenjat më të larta të mbështetjes dhe të solidaritetit vëllazëror.

Në emër të Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë dhe në emrin tim, ju lutem pranoni ngushëllimet tona më të sinqerta për humbjen e jetës së minatorëve, ndërsa për të plagosurit lusim Zotin për shërim sa më të shpejtë.

Justinian Topulli

Kryetari i Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë

Fq.4/ Intervistë e Kryetarit të Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë në lidhje me ndalimin e mbajtjes së shamisë

Fq.5/ Respektimi i prindërve në Islam

Nga hoxhë Emerim Koçi

Fq.7/ Aktualitet/ "Familje e shëndoshë - Atdhe i shëndoshë"

Fetva/

Kirurgjia kozmetike

Akademia Ndërkombëtare e Fikhut Islam

Vendimi nr. 173, 18/11

Asambleja e Akademisë Ndërkombëtare të Fikhut Islam, e dalë nga Organizata e Konferencës Islamike, e mbledhur në sesionin e saj të tetëmbëdhjetë në Buterxhaja (Malejzi), në datat 24-29/06/ 1428 h. 9-14 Korrik 2007, pasi mori në shqyrtim studimet e paraqitura në Akademi rreth kirurgjisë kozmetike dhe dispozitat që lidhen me të dhe dëgjoi diskutimet që bënë rreth temës, mori këtë vendim:

Së pari, përkufizimi i kirurgjisë kozmetike:

Kirurgji kozmetike (plastike, estetike) quhet kirurgjia që përdoret për zbukurimin (rregullimin) (e pamjes) e pjesëve të dukshme të trupit ose rikthimin e funksionit të tyre nëse ato dëmtohen.

Së dyti, rregullat dhe kriteret e përgjithshme që duhet të zbatohen gjatë operacioneve kozmetike:

1. Duhet që operacioni të përmbushë një interes të pranuar nga këndvështrimi islam, siç është rikthimi i funksionit organik, rregullimi i defekteve dhe rikthimi i krijimit në gjendjen e tij normale.

2. Operacioni nuk duhet të shkaktojë si pasojë një dëm më të madh sesa dobia që ai kërkon të përmbushë. Gjykim ky që jepet nga specialistët e besuar të fushës.

3. Operacioni duhet të kryhet nga mjekë (mjekje) të specializuar dhe përgatitur në këtë fushë, në mos ata mbajnë përgjegjësi (siç është sqaruar kjo në vendimin 142, 8/15 të Akademisë).

4. Operacioni duhet të kryhet me lejen e të sëmurit.

5. Mjeku specialist duhet të ndërjegjësoj pacientin, tek i cili do kryejë operacionin, për rreziqet dhe pasojat e sigurta dhe të mundshme, që vijnë nga ky operacion.

6. Të mos ketë tjetër mënyrë për mjekim, që të jetë më pak e ndjeshme dhe e dhimbshme për trupin sesa operacioni.

7. Të mos bihet ndesh me tekstet islame, siç është p.sh. fjala e Profetit (alejhi salatu ue selam): “Allahu e ka mallkuar atë që bën tatuazhe dhe atë që ia bënë, atë që heq vetullat dhe atë që ia heq, atë që i hap dhëmbët për zbukurim; ato që ndryshojnë krijimin e Allahut.” (Buhariu) dhe “Profeti mallkoi atë që vendos flokë (të huaja) dhe atë që ia bën këtë, atë që heq vetullat dhe atë që ia heq, atë që bën tatuazhe dhe atë që ia bënë; pa pasur ndonjë sëmundje.” (Ebu Daudi) Këtu përfshihen edhe ndalesa që Profeti (alejhi salatu ue selam) ka bërë që gratë të mos u ngajnë burrave dhe as burrat grave, si dhe ndalesa për të mos ngjarë me popujt e tjerë dhe mëkatarët

dhe njerëzit e pamorashëm.

8. Të respektohen gjatë operacionit rregullat e mjekimit, siç është mos veçimi me seksin tjetër, rregullat e zbulimit të vendeve intime, etj. me përjashtim të rasteve të domosdoshme ose nevojave të mëdha.

Së treti: Dispozitat fetare:

1. Lejohet sipas këndvështrimit islam të kryhen operacionet kozmetike të domosdoshme dhe të nevojshme, kur ato përfshijnë këto raste:

a) Rikthim të pamjes së organit të trupit, në gjendjen në të cilën është krijuar, nisur nga fjala e Allahut të Lartësuar: “Në të vërtetë, Ne e krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.” (Et-tin: 4)

b) Rikthim të funksionit fillestar që ka pasur organi i dëmtuar i trupit.

c) Rregullim të defekteve të lindura si p.sh.: çarje e buzës, shtrembërim i theksuar i hundës, nishane të stërmëdha, gishta ose dhëmbë të tepërt, gishta të bashkëngjitur; nëse ekzistenca e tyre ka pasojë të ndjeshme fizike ose jetësore.

d) Rregullimi i defekteve të shkaktuara nga pasojat e djegieve, aksidenteve, sëmundjeve etj., defekte këto që ndreqen nëpërmjet transplantimit të lëkurës, qepjes, rikthim të gjinjve në rastet kur janë hequr tërësisht ose pjesërisht, kur masa e tyre e madhe ose e vogël ka qenë në gjendje të sëmurë, transplantimi i flokëve kur kanë rënë, sidomos te gratë.

e) Largimi i shëmtimit, nëse kjo bëhet shkak për vuajtje fizike ose shpirtërore për personin.

2. Nuk lejohen operacionet kozmetike zbukuruese, të cilat nuk hyjnë te trajtimet mjekësore dhe kanë si qëllim ndryshimin e krijesës normale të njeriut, duke u shkuar pas dëshirave ose imituar të tjerët, si p.sh. operacionet për ndryshimin e formës së fytyrës, për të pasur një pamje të caktuar, apo me qëllim fshehtë të identitetit, për t'i ikur drejtësisë, ndryshimi i formës së hundës, zmadhimi apo zvogëlimi i buzëve, ndryshimi i modelit të syve, zmadhimi i faqeve.

3. Lejohet pakësimi i peshës (dobësimi) me anë të mjeteve mjekësore të besueshme, mes tyre edhe operacioni (Liposuction, largimi i dhjamit), nëse mbipesha shkakton sëmundje dhe nuk ka mënyrë tjetër në këtë rast vetëm se nëpërmjet operacionit, me kusht që të ketë siguri mosdëmtimi.

4. Nuk lejohet të zhduken rrudhat me anë të operacioneve apo injeksioneve, përderisa kjo nuk shkakton sëmundje, si dhe me kushtin që të ketë siguri nga pasojat dëmshme.

5. Lejohet qepja e himenit (cipa e virgjërisë), nëse ajo është dëmtuar aksidentalisht, nga përdhunimi apo dhuna. Por, nuk lejohet fetarisht, që të qepet himeni që është hapur nga një marrëdhënie imoraliteti, sepse kjo i hap rrugën mashtrimit dhe prishjes morale. Përparësi në kryerjen e trajtimeve të lejuara më sipër u jepen grave mjekje.

6. Mjeku specialist duhet t'i përmbahet rregullave morale fetare në

praktikën e tij mjekësore dhe të jetë konsulent i sinqertë me ata që kërkojnë operacione kozmetike, sepse feja është sinqeritet.

Akademia sugjeron:

1. Spitalet dhe klinikat e specializuara dhe mjekët që punojnë në to, duhet t'i përmbahen devocionit ndaj Zotit dhe të mos kryejnë operacione që nuk lejohen fetarisht.

2. Mjekët dhe kirurgët duhet të informohen me dispozitat fetare, që kanë të bëjnë me praktikën mjekësore dhe në veçanti me kirurgjinë kozmetike dhe të mos bëhen peng vetëm e përfitimit material, pa u siguruar më parë për gjykimin fetar rreth rastit konkret, si dhe të mos reklamojnë praktika mjekësore që përmbajnë gjëra të pavërteta.

Allahu e di më së miri!

A ka vërtetësi çështja e Natës së Regaibit?

*Komisioni i Përhershëm i Fetvasë Mbretëria e Arabisë Saudite
Fetvaja nr 6364 v.2 fq. 119*

Pyetje:

A ka vërtetësi çështja e Natës së Regaibit që thuhet se është natë e mirë dhe a duhet të ngritemi për adhurime dhe të agjërojmë?

Përgjigje:

Të gjithë ata që argumentohen për vlerën e Natës së Mirë të Regaibit mbështeten në disa hadithe të trilluara. Dy më të njohurat janë:

- “Kujdes, përpiku të rrish zgjuar natën e xhumasë së parë të muajit Rexhep, të mos e kalosh atë në shkujdesje, sepse engjëjt asaj nate ia kanë vënë emrin Regaib!”

- “Ai që e vlerëson natën e xhumasë së parë të muajit Rexhep (Nata e Regaibit), Allahu i Madhëruar nuk e dënon në varr”

Edhe pse qarkullojnë si të ndara të dyja tekstet janë pjesë e një hadithi të gjatë që e transmeton Gauth-thekalejn në librin e tij “Gunjetuttalibin”, Ebu Muhamed Abdul-Aziz el-Kinani në librin e tij “Fadlu Rexheb” dhe Ebu Musa El-Medini në “Vedhaiful-lejali”.

Imam Lekneviu në përmbledhjen e tij të haditheve të trilluara “El-athar el-merfuah fil-ahbar el-meuduah” 1/62 thotë: “Ky hadith është i shpikur dhe i trilluar dhe për këtë kanë rënë dakort të gjithë muhaddithinët (shkenctarët e hadithit), sepse shumica e transmetuesve në zinxhirin e tij nuk njihen dhe disa transmetues të tjerë janë gënjeshtarë.” Të njëjtin gjykim për këtë hadith e citon imam Bejhekiu, Ibnul Xheuzi, Dhehebiu, Askalani, Mulla Alij El-Karij el-hanefi, Hafidh El-Iraki, El-Fiteni, El-Axhluni, Esh-Sheukani etj. Gjithashtu imam Lekneviu sqaron se shpikësi dhe trilluesi i namazit të natës Regaib është Ali ibn Abdil-lah ibn Xhehdam, prijësi i sufistëve në kohën e tij, i cili ka vdekur në vitin 414 sipas hixhretit. Kjo do të thotë se ky adhurim dhe madhërimi i kësaj nate jo vetëm që është i shpikur, por mbi të gjitha është është shfaqur 4 shekuj pas. Prandaj shikojmë se kjo gjë nuk ka qenë e njohur aspak te brezi i sahabëve, tabiinëve dhe

pasuesit e tyre dhe te katër medh'hebet e njohura islame.

Ndërkohë imam Neveviu në shpjegimin e Muslimit 8/20 kur tregon për natën e Regaibit dhe veçimin e natës së xhumasë me adhurime thotë: “Të gjithë (ulematë) kanë rënë dakort se kjo gjë është diçka e urryer që e bëjnë bidatçitë. Allahu e shkatërroftë atë që e ka shpikur këtë lloj namazi në këtë natë, sepse ajo është njëra prej bidateve të urryera dhe të humbura që vijnë nga injorantët. Shumë prej imamëve kanë shkruar libra të çmuara për këtë çështje ku kanë treguar sa e shëmtuar është kjo vepër dhe sa të humbur janë ata që e zbatojnë këtë gjë.”

Edhe ajo që përmendet se gjoja Amineja, nëna e Profetit (alejhisalatu uesselam) ka mbetur shtatzënë në këtë natë, ose ka kuptuar se është shtatzënë pikërisht në këtë natë janë pretendime të sajura dhe të shpikura që nuk kanë asnjë argumentim nga feja dhe as mbështetje logjike.

Po ashtu duhet të theksojmë se përveç natës së Regaibit që mbështetet në hadithe të trilluara, edhe hadithet që flasin për muajin Rexheb ku ndodhet kjo natë gjithashtu janë të dobta dhe të shpikura. Në ato hadithe përmendet se vlera e muajit Rexhepit nga muajt e tjerë është si vlera e Kuranit nga fjalët e tjera dhe kush agjëron një ditë nga Rexhepi do të pijë ujë Ditën e Gjykimit nga një lumë që quhet Rexhep. Kush agjëron një ditë nga Rexhepi është sikur ka agjëruar gjithë vitin, kush agjëron shtatë ditë nga Rexhepi do t'i mbyllën shtatë dyert e Xhehenemit, kush agjëron tetë ditë nga Rexhepi do t'i hapen tetë dyert e Xhenetit dhe kush agjëron pesëmbëdhjetë ditë nga Rexhepi do t'i falen të gjitha mëkatet e mëparshme. Kush agjëron të enjten e parë të muajit Rexhep dhe kalon me adhurime natën e Xhumasë së parë të këtij muaji do t'i falen të gjitha gabimet dhe do të ketë të drejtë të ndërmjetësosë për 70 vetë nga familja e tij Ditën e Gjykimit. Dijetarët islamë nga ata që përmendëm më sipër si dhe Imam Ibn Rexhepi, Imam Ibn Tejmije, hafidh Ebu Ismail El Herauij” e plot të tjerë kanë sqaruar se këto hadithe e të tjera që flasin për Muajin Rexhep janë hadithe të rëna, të përjashtuara dhe të trilluara në të cilat nuk mund të mbështetesh për të punuar diçka me vlerë.

E pra, madhërimi i muajve ose i netëve të veçanta nuk bëhet sipas dëshirës së askujt dhe as sipas logjikës së njerëzve. Duhet të rikujtojmë besimtarëve se adhurimet në fenë islame bëhen ashtu siç na ka mësuar Allahu i Madhëruar dhe i Dërguari i Tij Muhamedi (alejhi salatu ue selam) dhe jo sipas mendimit, dëshirës apo traditës së njerëzve, sepse siç na ka treguar Profeti (alejhisalatu uesselam) çdo risi në fe të çon në humbje. Ndërsa sahabiu i nderuar Hudhejfe ibnul Jeman thotë: “Çdo adhurim të cilin nuk e kanë praktikuar shokët e ndershëm të Profetit a.s mos e praktikoni as ju, sepse të parët nuk kanë lënë gjë për thënë për ata që vijnë më pas.” Ndërsa Abdullah Ibn Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) thotë: “Çdo bidat është në humbje edhe sikur njerëzit ta shohin atë si të mirë.”

Komisioni Pyetje & Përgjigjeve pranë LSH

Bordi botues:
Justinian TOPULLI
Genc PLUMBI
Mustafa TËRNIQI

LIDHJA HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË

Unaza e Re, Rruga: "Teodor Keko" Pallati Edglis, Tiranë-Shqipëri
lidhjehoxhallareve@yahoo.com
Tel & Fax: +355 (0)48320160
http://www.lidhjehoxhallareve.com

Përfaqësuesi i LSHH-së për Marrëdhëniet me Jashtë takohet me Sekretarin e Përgjithshëm të Ligës së Botës Islame në Mekë

Më datë 06/04/2014, në mesinë qëndrore të Ligës së Botës Islame në Mekë, Përfaqësuesi i Marrëdhënieve me Jashtë dhe i Projekteve pranë Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë, hoxhë Emerim Koçi, u prit në një takim zyrtar nga Sekretari i Përgjithshëm i kësaj organizate, shejh Abdullah el Turki.

Pasi shprehu falënderimin e tij për bashkëpunimin e deritanishëm mes Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë dhe Ligës së Botës Islame, përfaqësuesi i LSHH-së, hoxhë

Emerim Koçi shprehu gatishmërinë për zgjerimin e këtij bashkëpunimi në fusha të ndryshme, posaçërisht në fushat e studimeve islame dhe fetvave, ngritjes së institucioneve të përbashkëta për zhvillimin e arsimit në të gjitha nivelet, ngritjen e qendrave kulturore dhe fetare për muslimanët e rinj dhe në veçanti për përkrahjen e hoxhallarëve në fushën ekonomike dhe shkencore, si dhe në këmbimin e eksperiencave përmes takimeve dhe aktiviteteve të ndryshme.

Nga ana tjetër shejh Abdullah

el Turki, Sekretari i Përgjithshëm i kësaj organizate shprehu kënaqësinë për bashkëpunimin e deritanishëm me Lidhjen e Hoxhallarëve të Shqipërisë, si dhe për rolin e saj në orientimin fetar të njerëzve dhe premtoi për një vizitë zyrtare në Shqipëri.

Gjithashtu ai shprehu gatishmërinë për zgjerimin e këtij bashkëpunimi, sidomos me Këshillin



Botëror për Mësimin e Kuranit dhe Këshillin Botëror të Dijetarëve Muslimanë.

(...vijon nga faqja 1) Nga informacionet e marra në rrugë të ndryshme si: vëzhgimet, debatet e njoftimet në media për mbajtjen e shamisë nga nxënëset dhe studentët në shkollë, del në pah problemi që lidhet me faktorët që çojnë në këtë mbulim.

Për këtë problem, dy argumentet kryesore të kundërshtuesve kanë të bëjnë me pretendimet se gjoja mbulimi i vajzave me shami është:

a) jo një shprehje e vullnetit të tyre të lirë, por rezultat i presionit fizik dhe/ose psikologjik shoqëror që është ushtruar mbi to nga familja ose mjedisi shoqëror;

b) rezultat i manipulimit të vajzave në moshë të vogël dhe të paditura.

Ndonjëherë pre e këtyre opinionëve që merren si të mirëqëna, bien edhe studiues serioz dhe të shquar. Për ta ilustruar këtë po sjell fragmente nga një artikull i një akademiku shqiptar (Prof. Artan Fuga) i botuar në gazetën "Mapo", me titullin "Laiciteti i shkollës parakusht për bashkëjetesën fetare". Duke diskutuar për një dispozitë që shteti shqiptar kishte nxjerrë për të ndaluar ekspozimin e simboleve fetare në shkolla, profesori thotë: "Ka një arsye të madhe që të supozohet se një dispozitë që ndalon ekspozimin e simboleve fetare në arsimin parauniversitar mund të jetë e dobishme. Nuk kam gjë kundër kur thuhet se ajo mund të çënojë lirinë e shprehjes të opinionëve fetare. Dakord. Hajde ta marrim përkohësisht të mirëqenë. Por, për lirinë e atyre fëmijëve që mund të detyrohen, jashtë vullnetit të tyre, të mbajnë këtë apo atë simbol fetar, a nuk ka vend të mendojmë? Këtë pyetje e bën autori i këtyre radhëve, i cili, kur ishte rasti i përjashtimit të disa vajzave nga një universitet publik disa vite më parë, sepse mbanin shami në kokë, është shprehur kundër kësaj mase në publik. Atëherë, përse në atë kohë u mbajt ai qëndrim, e tani jo më i njëjti pozicion? Përgjigjja është e thjeshtë dhe e ndershme: Sepse atëherë bëhej fjalë për të reja që ishin në moshën e pjekurisë dhe që me ndërjegje të lirë mund të vendosnin për t'i mbajtur apo jo shaminë e tyre mbi kokë. Për

ato mosha çështja shtrohet ndryshe. Duhet me qenë tolerantë, nëse nuk ka imponim ose dhunim nga të tretë."

Pra pikërisht në këto fragmente duken qartë të dy argumentet (a dhe b) që pretendohen nga njerëzit që diskutojnë për këtë temë.

Synimi i këtij punimi, midis të tjerave, është që të tregoj se që të gjitha argumentat e lartpërmendura nuk janë të pranueshme, ngaqë nuk i rezistojnë dot shqyrtimit kritik të bazuar edhe në të dhëna studimore, se ato bazohen kryesisht në paragjykime, të cilat, shpesh "importohen" nga jashtë shoqërisë shqiptare. Ndryshe nga ç'paragjykohej, femrat që mbulohen me shami në shoqërinë shqiptare, nuk diskriminohen në trajtën e detyrimit forcor ose psikologjik për t'u mbuluar, por në atë të ushtrimit të dhunës psikologjike që disa herë degradon në dhunë fizike, për të hequr mbulesën.

Në këtë studim u morën dy supozime bazë, të cilat janë të kundërta me njëra -tjetrën, për të parë se cili prej tyre i përket realitetit tonë:

1. Në shoqërinë shqiptare në tranzicion ushtrohet një presion social që vajzat të mbulohen.

2. Në shoqërinë shqiptare në tranzicion ushtrohet një presion social që vajzat e mbuluara të heqin shaminë.

Për secilin nga supozimet u bënë një sërë pyetjesh në mënyrë që nga përgjigjet që femrat e mbuluara do jepnin do kuptohej se cili nga supozimet qëndron. Përsa i përket supozimit të parë u shtrua pyetja "A jeni penduar që jeni mbuluar?" dhe doli se 99, 2 % e grave dhe vajzave u përgjigjën "Absolutisht jo". Nëse këto gra dhe vajza do ishin detyruar të mbuloheshin për shkak të moshës së vogël apo injorancës atëherë do hasej një pendim i mundshëm ndërmjet tyre, sepse nëse ky mbulim do kishte qenë i detyruar ose si rezultat i manipulimit të tyre, me kalimin e viteve këto femra do pendoheshin për mbulimin. Por rezultati i anketimit flet shumë qartë për këtë.

Gjithashtu është pyetur: "A ju ka detyruar dikush të mbuloheni pa dëshirën tuaj?" dhe 99.6% e të

pyeturave mohojnë absolutisht një detyrim të tillë, që do të thotë se mund të konsiderohet që femrat janë mbuluar me vullnetin e tyre të lirë.

Gjithashtu u pa se, nga 99.6% e të anketuarave që deklarojnë se absolutisht nuk janë penduar për mbulimin, vetëm 27.1% e të anketuarave kanë nivel të ulët arsimimi, kundrejt 72.8% që kanë nivel mesatar, të lartë dhe pas universitar. Një e dhënë e tillë do të thotë se mund të konsiderohet se nuk qëndron pretendimi se femrat janë mbuluar për shkak të padijes së tyre. Edhe fakti se 72,8% e femrave me shami kanë nivel arsimimi mesatar, të lartë dhe pas universitar, është shumë i rëndësishëm kundër thyerjes së mitit se këto femra mbulohen nga injoranca e tyre.

Kurse për supozimin e dytë (Në shoqërinë shqiptare në tranzicion ushtrohet një presion social që vajzat e mbuluara të heqin shaminë) u bë pyetja "A ju ka kundërshtuar dikush për vënien e shamisë?" dhe del se të anketuarat në masën e afro 60% deklarojnë se i kanë kundërshtuar plotësisht ose në një farë mase për aktin e mbulimit të tyre. Kjo shifër flet qartë për ushtrim presioni jo për t'u mbuluar, por për të hequr mbulimin.

Nga një tjetër pyetje që u bë: "A ndjeheni e paragjykuar nga shoqëria?", del se të anketuarat në masën e afro 72% deklarojnë se ndjehen tërësisht ose në një farë mase të paragjykuara nga shoqëria. Gjithashtu ato deklarojnë se kanë hasur ofendime nga më të ndryshmet nga njerëzit si: e prapambetur, injorante, ekstremiste, fanatike, fshatare, e paguar, e çmendur e deri në terroriste. Këto të dhëna tregojnë dhe një herë ndjenjën relativisht masive të diskriminimit të femrave të mbuluara nga shoqëria.

Nga pyetja "A ka ushtruar dikush dhunë psikologjike ndaj jush që të mos vendosnit shaminë?", doli se të anketuarat në masën e afro 32% deklarojnë se ndaj tyre është ushtruar tërësisht ose në një farë mase dhunë psikologjike për të mos u mbuluar.

Kurse pyetjes "A ka ushtruar dikush dhunë fizike ndaj jush që

të mos e vendosnit shaminë?", mbi 5% e të anketuarave deklarojnë se mbi to është ushtruar dhunë fizike për të hequr shaminë.

Këto të dhëna janë shumë të rëndësishme, sepse për herë të parë nxjerrin në pah dicka që nuk është thënë asnjëherë në media, fakti që këto vajza nuk janë dhunuar për t'u mbuluar por janë dhunuar psikologjikisht dhe një masë prej tyre edhe fizikisht që të heqin shaminë. Këtë fakt në studim e përforcojnë edhe katër intervista të zgjeruara ku vajzat tregojnë me detaje historinë e mbulimit të tyre dhe dhunën që është ushtruar ndaj tyre, dhunë prej së cilës në njërin nga rastet vajza ka përfunduar në spital.

Një fakt tjetër që nxjerr në pah diskriminimin e këtyre vajzave është edhe çështja e (mos) punësimit të tyre. Sipas anketimit del se nga të anketuarat 73% janë të papunësuarat, 18% janë të punësuarat në privat, 5% në OJF, 2% të vetëpunësuarat dhe vetëm 2% të punësuarat në shtet. Pra edhe vetë shteti, ai që duhet të bëjë politikë antidiskriminuese, është i pari që i diskriminon në maksimum këto vajza.

Gjithashtu është bërë pyetja "Sa kohë keni që jeni mbuluar?" dhe ka dalë se vetëm 10% e femrave me shami janë mbuluar para 1997, më pas ky numër ka ardhur duke u rritur dhe deri në 2011 numri i femrave me shami është 9 fishuar. Nëse këto femra do mbuloheshin sepse ishin të vogla dhe injorante dhe familja i detyronte atëherë numri i tyre me kalimin e viteve do ulej sepse ato do rriteshin dhe do shkolloheshin, dhe me emancipimin e shoqërisë edhe ato do të "emancipoheshin". Por ne shohim që ka ndodhur e kundërta, numri i tyre është shumëfishuar. Pra edhe kjo e dhënë hedh poshtë pretendimet që ngrihen ndaj femrave me shami.

Pra, si rezultat i këtij studimi del se në realitetin e sotëm shqiptar, me mbulimin e femrave lidhet problemi i ushtrimit të presionit social, që shkon në raste të veçanta deri në ushtrimin e dhunës fizike, për të hequr mbulimin dhe jo në atë të detyrimit forcor për t'u mbuluar.

INTERVISTË E KRYETARIT TË LIDHJES SË HOXHALLARËVE TË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME NDALIMIN E MBAJTJES SË SHAMISË

Hoxhë Justinian Topulli
Kryetar i Lidhjes së Hoxhallarëve të Shqipërisë

Es- Selamu Alejkum ue rahmetullahi ue berekatuhu!

Allahun e falënderojmë ndërsa paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin (alejhialatu ue selam)

Hoxhë i nderuar, ju falënderojmë për kohën që po ndani për intervistën tonë, ku së bashku për disa çaste të bashkëpunojmë në mirësi dhe devotshmëri, me qëllim arritjen e së mirës dhe devotshmërisë.

Faqja jonë "Në Mbrojtje të Shamisë" synon të merret vetëm me tematikën e të drejtës së mbajtjes së shamisë, duke u fokusuar në trojet tona shqiptare.

A mendoni se sot duhet të intensifikohen aktivitetet e xhematit, hoxhallarëve, organizatave të ndryshme dhe institucioneve fetare në mbrojtje të këtij obligimi fetar?

- Së pari, ju përgëzoj për këtë nismë mjaft të mirë që keni marrë, në mbrojtje të një nga obligimeve të rëndësishme islame, siç është shamia, ose më saktë mbulesa islame e gruas muslimane.

Së dyti, çështja e shamisë është pjesë e fesë dhe si e tillë ajo nuk mund të ndahet prej saj, ndaj unë mendoj se ajo duhet të jetë pjesë e pandashme e thirrjes islame, krahas parimeve të tjera islame. Duke qenë se jetojmë në një rajon dhe një kohë kur Islami shihet si i huaj nga një pjesë e shoqërisë dhe shamia e gruas muslimane është një nga obligimet më të refuzuara dhe të keqkuptuara islame nga kjo shoqëri, atëherë edhe predikimi rreth këtij obligimi duhet të bëhet i përshkallëzuar dhe me maturi të madhe. Krahas predikimit për rëndësinë dhe obligimin e shamisë, duhet të kihet parasysh gjithashtu edhe gjuha e përdorur për ta bërë shaminë sa më të dashur dhe të pranueshme nga gratë, jo thjesht si një detyrim fetar i thatë, por si një obligim i cili mbart urtësi të mëdha shpirtërore në vetvete.

- A mendoni se shamia është nga simbolet e dukshëm të fesë që është duke u sulmuar më së shumti tek ne shqiptarët kudo që jemi?

Natyrisht që po. Të njëjtën situatë ka edhe mjekra e besimtarëve, por shamia është ajo që shpesh kontestohet më tepër, sepse shihet si dhunim ndaj gruas. Por, në fakt ky refuzim më së shumti vjen për shkak të prirjes së fuqishme kulturore perëndimore që ka në mesin e shqiptarëve.

Periudha që ka kaluar shoqëria shqiptare nga koha e shpalljes së

Pavarësisë së cunuar më 1912, a ka ecur në trendët e shoqërisë së kohës, apo ka pas projekte të hartuara nga të tjerët për ta ulur vlerën e shamisë (mbulesës)? Po sot a ka trende të tilla dhe në funksion të kujt mund të jenë këto projekte për denigrimin e femrës shqiptare?

Mendoj se ka qenë pjesë e transformimeve shoqërore, politike dhe kulturore që përsuan trojet shqiptare pas shpërndarjes nga shteti osman. Veç kësaj ka qenë një periudhë e rëndë në përgjithësi për muslimanët në të gjithë botën në atë kohë, ndaj kjo nuk kishte si të mos reflektohej edhe në besimin e njerëzve dhe gatishmërinë e tyre për të zbatuar shumë prej obligimeve islame. Por, ka pasur gjithashtu një fushatë me frymë oksidentalizmi të shqiptarëve që mori hov nga politika që ndoq në kohën e Ahmed Zogut dhe që u pasua më pas nga rrëgjimi komunist i Enver Hoxhës, në emër të asaj që quhej emancipim i gruas. I njëjti trend vazhdon edhe sot edhe pse natyrisht për shkak të rënies së diktaturave të dikurshme njerëzit janë shumë më të lirë se dikur për të zbatuar detyrimet e tyre fetare. Çështja në thelb ka të bëjë me modernitetin, me të cilin kuptojmë racionalizimin e shoqërisë njerëzore, zhvillimin shkencor dhe teknologjik dhe ekspansionin kulturor që mundësohet nga këto zhvillime. Duke qenë se burimi i modernitetit ka qenë dhe vazhdon të jetë perëndimi i pasur dhe i fuqishëm, atëherë është e kuptueshme se prirjet e tij kulturore do të ndjehen në të gjithë botën, dhe në veçanti në vendet më pranë tij dhe më të dobët për ta përballuar pushtimin e tij kulturor. Duke qenë se zhvillimi i modernitetit në perëndim ka shkuar krahas për krahas me shekullarizimin, atëherë është e kuptueshme se pse feja dhe praktikata e saj janë dobësuar edhe në ato vende që kanë në origjinë një tjetër kulturë, por që nuk kanë mundur dot t'i bëjnë ballë kulturës masive shekullare që përhap perëndimi.

- Dihet nga historia e religjioneve se edhe tek dy fetë e tjera që kanë pasur libra qiellor, ajo judaike dhe e krishterë, mbulesa ka qenë e obliguar, si ndodhi ky ndryshim kaq i madh tek këto fe në nivel botëror?

Për të njëjtin shkak që përmenda më sipër. Moderniteti në perëndim u shoqëruar me rënien e besimit fetar në shumë dimensione dhe mes tyre edhe detyrimi që gratë të ishin të mbuluara. Edhe pse krahas kësaj ka edhe arsye të tjera, të trashëgimisë së tyre kulturore, që mundësuan këtë ndryshim në mënyrë më të lehtë. Për arsye historike që dihen hebrenjtë kanë jetuar në vende të ndryshme kështu që kultura

e tyre fetare është ndikuar nga vendet përkatëse. Duke qenë se pjesa më e madhe e tyre kanë jetuar në vende të krishtera, atëherë është më se normale që ata të ndikoheshin nga të njëjtat ndryshime që përsuan këto shoqëri. Megjithatë, edhe pse në shoqëri të tilla, gjen edhe pse në numër të vogël si në mesin e hebrenjve ashtu edhe mes të krishterëve, gra të cilat e ruajnë këtë traditë fetare, qofshin këto murgësia ose jo të tilla.

- Duke u bazuar në atë që thatë më lartë cila mund të jetë rruga e kthimit të traditës së shamisë në trojet tona shqiptare?

Padyshim me kthimin e besimit dhe vlerave të tij. Predikimi i Islamit dhe i vlerave të tij sociale nuk duhet të mbyllet brenda mureve të xhamisë, por duhet të dalë jashtë tyre. Më shumë se një predikim i thatë duhet një praktikë e gjallë, sepse kjo i tërheq më shumë njerëzit drejt besimit. Besimtarët me shami duhet të jenë shembulli i gjallë i një morali të lartë, në sjellje dhe marrëdhënie me njerëzit, ato gjithashtu duhet të reflektojnë veç etikës edhe dimensionin e tyre arsimor, për të treguar shoqërisë se shamia nuk është pengesë për arsimin dhe ngritjen intelektuale të një gruaje edhe pse gruaja para së gjithash është edukatorja e brezave. Është e rëndësishme gjithashtu që mbulesa islame në këto troje të përshtatet me ambientin tonë, brenda rregullave islame. Pra të jetë edhe modeste, mbuluese e trupit, por edhe të hijshme, e të mos tërheq vëmendjen e njerëzve, me ngjyrat apo format dhe modelet e saj, qofshin këto me ngjyra të errëta dhe shumë të gjera, apo me ngjyra të ndezura dhe shumë të ngushta.

- Shamia nga disa paragjykohet, kuptohet si mbyllje në vete, cënim i lirisë së femrës, barrë e rëndë mbi supe deri tek mënyrë e imponuar e veshjes nga burrat, cili është këshilla juaj për këtë?

Siç e thashë edhe më sipër bota shoqërore që na rrethon është ajo që formëson bindjet dhe mendësinë e njerëzve, ndryshimi i këtyre mendësive të gabuara kërkon ndryshimin e mbarë shoqërisë dhe këtë më mirë se praktika dhe shembulli i gjallë nuk e bën askush. Vetë gratë besimtare me shembullin e tyre duhet të tregojnë se ky mentalitet është i gabuar dhe se rastet e veçanta nuk mund të shërbejnë kurrësi si përgjithësim. Natyrisht që kjo është një betejë e gjatë dhe e vështirë, por rrugë tjetër nuk ka.

- Me cilat mjete më së shumti sot

luftohet shamia dhe cilat janë mjetet më efikase për tu mbrojtur nga këto sulme?

Siç e përmenda edhe më sipër, në emër të emancipimit, ose në emër të laicitet të hapësirës publike, në emër të gjoja zhvillimit dhe kulturës, në emër të lirisë seksuale etj. Së pari për tu mbrojtur nga këto sulme kërkohet besim i fortë dhe bindje për drejtësinë e çështjes. Së dyti, duhet që çështja e shamisë të mbrohet nën të drejtat dhe liritë e individit që siguron ligji. Së treti, nëpërmjet armatosjes me dije dhe kulturë të gjithanshme për të përballuar këto sulme. Dhe së katërti dhënia e një shembulli sa më të mirë se çfarë vlerash dhe moral mbart një grua me shami.

- Ndalimin e bartjes së shamisë në shkolla publike si e shikoni ju, si një shtet i mirë për shtimin e praktikuesve apo si tendencë për zhdukjen e tërësishme të kësaj pjese të fesë?

Tani kjo është çështje që ka të bëjë me caktimin e Zotit dhe është e vështirë shpesh të lexosh nga realiteti se cila do të jetë e ardhmja, sepse mund të ndodhin të dyja, mund që edhe të shtohen, nëse gjendet një alternativë tjetër, por edhe të pakësohen. Gjithsesi, e përgjithshme është që ndalimi i shamisë në shkollat publike ndikon negativisht në mbartjen e saj dhe kjo e demoralizon përhapjen e këtij detyrimi fetar në mesin e grave muslimane. Padyshim që mos ndalimi i shamisë dhe një klimë sa më e pranueshme për shaminë është një terren që e favorizon shtimin e saj, ashtu si edhe siç vlen edhe e kundërta.

- Cilat mund të jenë masat konkrete që mund të marrim ne si xhemat, së bashku me hoxhallarët dhe institucionet fetare që të realizohet e drejta e bartjes së shamisë në shkollat publike në Kosovë edhe në Shqipëri?

Iniciativat në këtë drejtim janë të shumta, por së pari duhet që vetë gratë dhe besimtarët, siç e thashë më sipër të jenë të bindur dhe të palëkundur për ta mbrojtur këtë çështje deri në fund. E dyta, duhet që të ushtrohet trysni ndaj politikës me të gjitha format legjitime, qofshin këto nisma ligjore, peticione, të drejtat e njeriut, deri edhe me të drejtën për t'i penalizuar me votë. E treta promovimi sa më i madh i vlerave dhe virtyteve që mbart shamia, por edhe vetë besimi, nëpërmjet fletëpalosjeve, librave, emisioneve televizive, hutbeve, simpoziumeve etj. Dhe padyshim ajo çka është më e rëndësishme besimi të Zoti dhe lutja drejtuar Atij, që të na jap sukses në këtë drejtim.

(vijon në faqen 5...)

RESPEKTIMI I PRINDËRVE NË ISLAM

Nga hoxhë Emerim Koçi

Falënderimet dhe lavdërimet i takojnë vetëm Allahut [xh. sh.], salavatet qofshin mbi të Dërguarin e Tij Muhamedin (s.a.v.s), familjen e tij, shokët e tij dhe gjithë muslimanët që ndjekin rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Me të vërtetë respektimi i prindërve është një obligim shumë me rëndësi. Allahu [xh.sh.] e ka krahasuar respektimin dhe dëgjimin e prindërve me dëgjimin dhe respektimin e Tij.

1. Allahu [xh.sh.] thotë: **“Zoti yt ka urdhëruar që të mos adhuroni tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë respektive e bamirëse ndaj prindërve.”**[El Isra, 23]

Allahu [xh.sh.] në këtë ajet e ka krahasuar mosrespektimin e prindërve me shirkun. Gjithashtu, Allahu [xh.sh.] thotë: **“Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindit të vet.”**[Llukman, 14]

2. Allahu [xh.sh.] na ka urdhëruar që të sillemi mirë me ta dhe t'i respektojmë edhe nëse janë qafira (pabesimtarë) ku thotë: **“E nëse ata të dy të urdhërojnë që ti të më përshkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos iu bind atyre, por në çështjet e jetës së kësaj bote të keshë mirëkuptim dhe respekt ndaj tyre.”** [Llukman, 15]

Transmeton Muslimi nga Esma, e bija e Ebu Bekrit, se ka thënë: *“Ka ardhur tek unë nëna ime e cila në atë kohë ishte mushrike (idhujtare), dhe e pyeta Pejgamberin (s.a.v.s) duke i thënë: ‘O i Dërguar i Allahut, më ka ardhur nëna e cila e urren gjendjen time në të cilën jam (Islamin e saj), pra a ta vizitoj nënën time?’ Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: ‘Po vizitoje nënën tënde.’”* [Muslimi dhe Buhariu]

3. Gjithashtu respektimi i prindërve konsiderohet Xhihad, sakrificë. Transmeton Abdullah ibn Amri (r.a.) ka thënë: *“Ka ardhur një person tek i Dërguari i Allahut (s.a.v.s) dhe ka kërkuar leje nga Pejgamberi (s.a.v.s) që të merr pjesë në Xhihad. Pejgamberi (s.a.v.s) e pyeti: ‘A i ke të gjallë prindërit?’ Ai iu përgjigj: ‘Po.’ Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: ‘Xhihadi yt është tek ta.’ Sakrifiko tek ata.”* [Buhariu dhe Muslimi]

Gjithashtu transmetohet nga Enesi (r.a.) se ka thënë: *“Ka ardhur një person tek Pejgamberi (s.a.v.s) dhe i tha: ‘Me të vërtetë unë kam dëshirë për*

të luftuar (për Xhihad), mirëpo nuk po kam mundësi.’ Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: ‘A e ke ndonjërin prej prindërve gjallë?’ Ai tha: ‘Po, e kam nënën time.’ Pejgamberi (s.a.v.s) iu përgjigj: ‘Ndreqni marrëdhëniet me Allahun [xh.sh.] duke i respektuar prindërit. Nëse e bën një gjë të tillë (nëse i respekton prindërit) atëherë ti ke bërë Haxxin, Umren dhe Xhihadin.” [Taberaniu. Mundhiri ka thënë se zinxhiri i këtij hadithi është i mirë]

Në disa hadithe Pejgamberi (s.a.v.s) i ka dhënë përparësi respektimit të prindërve ndaj Xhihadit. Transmetohet se Abdullah ibn Mesudi (r.a.) ka thënë: *“E kam pyetur Pejgamberin (s.a.v.s) se cila vepër është më e mira? Pejgamberi (s.a.v.s) u përgjigj: ‘Falja e Namazit në kohën e vet.’ I thash: ‘Pastaj cila?’ Tha: ‘Respektimi i prindërve.’ I thash: ‘Pastaj cila?’ Tha: ‘Xhihadi në rrugën e Allahut.’”* [Buhariu dhe Muslimi]

4. Respektimi i prindërve është shkak për hyrje në Xhenet. Transmeton Ebu Darda (r.a.) se e ka dëgjuar Pejgamberin (s.a.v.s) duke thënë: *“Prindërit janë dera e mesme e Xhenetit, pra nëse dëshiron humbe atë derë ose fitoje atë.”* [Tirmidhiu, dhe ka thënë se hadithi është sahih] Kushejri ka thënë: *“..dera e mesme e Xhenetit, ka për qëllim, derën më të mirë të Xhenetit.”*

Transmetohet nga Muavija ibn Xhahime, se Xhahime ka ardhur tek Pejgamberi (s.a.v.s) dhe e ka pyetur: *“O i Dërguar i Allahut, unë kam dëshirë që të luftoj në rrugën e Allahut, dhe kam ardhur tek ti që të konsultohem.”* Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: *“A e ke gjallë nënën?”* Tha: *“Po,”* Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: *“Kryej nevojat e nënës tënde, se me të vërtetë Xheneti është tek këmbët e saja.”* [Ahmedi, shejh Albani ka thënë se ky hadith është Hasen]

Në transmetimin e Taberaniut qëndron se Pejgamberi (s.a.v.s) e ka pyetur: *“A i ke prindërit gjallë?”* I thash: *“Po,”* Tha pejgamberi (s.a.v.s): *“Kryej nevojat e tyre, se me të vërtetë Xheneti është nën këmbët e tyre.”* [Albani ka thënë se ky hadith është Sahih]

5. Kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve. Transmeton Abdullah ibn Amri (r.a.) se Pejgamberi (s.a.v.s) ka thënë: *“Kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve, dhe pakënaqësia e Allahut është në*

pakënaqësinë e prindërve.” [Tirmidhiu, këtë hadith e kanë bërë sahih Ibn Habbani, Hakimi dhe Albani]

6. Respektimi i prindërve është shkak për faljen e mëkateve. Transmeton Ibn Omeri (r.a.), se një njeri ka ardhur tek Pejgamberi (s.a.v.s) dhe i tha: *“O i dërguar i Allahut, unë kam bërë një mëkat të madh, a ka pendim për mua?”* Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: *“A ke nënë?”* Ai i tha: *“Jo,”* Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: *“A ke teze?”* Iu përgjigj: *“Po,”* Pejgamberi (s.a.v.s) i tha: *“Pra respektoje (dëgjoje) atë.”* [Tirmidhiu, dhe ka thënë se hadithi është sahih]

Pra kjo tregon se respektimi i prindërve është shkak për shlyerjen e mëkateve, pasi që Pejgamberi (s.a.v.s) iu përgjigj këtij mëkatari duke e pyetur se a ka nënë që ta respektoj dhe ta dëgjoj atë, kështu që t'i shlyejë mëkatet me respektimin e saj. Gjithashtu, transmeton Malik ibn Amri se Pejgamberi (s.a.v.s) ka thënë: *“Ai i cili e liron një rob musliman, do të jetë shkaktarë për shpëtimin e tij nga Zjarri, kurse ai i cili e ka njërin prej prindërve të gjallë dhe ata nuk ia falin atij (nuk ia bëjnë hallall), Allahu [xh. sh.] do ta largojë atë shumë larg (do ta mallkojë)”* [Ahmedi. Hadithi është hasen].

7. Respektimi i prindërve është edhe shkak për largimin e ndonjë fatkeqësie.

Argument për këtë është ngjarja e tre personave që kanë hyrë në shpellë dhe një gurë i madh ka rënë dhe ua ka mbyllur daljen. Në këtë gjendje, secili

prej tyre e ka lutur Allahun [xh.sh.] me punët që ka bërë për hir të Tij dhe njëri prej tyre e ka lutur Allahun [xh. sh.] me respektimin e prindërve, duke thënë: *“O Allah nëse këtë vepër e kam bërë për Hirin Tënd, largona neve këtë shkëmb që të mund të dalim”.* Allahu [xh.sh.] ia largoi shkëmbin dhe dolën nga shpella. [Buhariu dhe Muslimi]

8. Transmeton Ebu Hurejra (r.a.) se Pejgamberi (s.a.v.s) ka thënë: *“Nuk ka mundësi fëmija t'ia kthejë hakun prindit të tij, përveç nëse e sheh prindin e tij se është zënë rob, pastaj blenë atë dhe e liron.”* [Muslimi]

9. Mosrespektimi i prindërve është nga mëkatet më të mëdha. Transmeton Ebu Bekre (r.a.) se Pejgamberi (s.a.v.s) ka thënë: *“A dëshironi t'ju tregoj për mëkatet më të mëdha?”* Këtë e përsëriti tri herë. Ne i thamë: *“Po, o i Dërguar i Allahut.”* Pejgamberi (s.a.v.s) tha: *“T'i bësh shirk (shok) Allahut dhe mosrespektimi i prindërve...”* [Buhariu dhe Muslimi]

O vëlla i dashur, pasi e kuptove rëndësinë e respektimit të prindërve dhe dënimin e atij që nuk i respekton prindërit, shpejto dhe respektoj ata, dëgjoji ata (përveç nëse të urdhërojnë në mëkatet), mos i thuaj atyre as “uf” dhe lute Allahun që t'i mëshirojë ata. Allahu [xh. sh.] thotë: **“Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahu përulës e respektues dhe thuaj: ‘Zoti im! Mëshiroji ata të dy, sikurse më edukuan dhe me mëshiruan mua kur isha i vogël.’”**[El Isra, 24]



MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329

- Cili është mesazhi i juaj për ato vajza që hezitojnë të vendosin shaminë nga frika e përjashtimit nga shkolla?

Të jenë vetvetja dhe të mos bëjnë kompromis me identitetin e tyre dhe detyrimin që u ka caktuar Zoti dhe të mos harrojnë se ato janë shumë dhe kjo betejë nuk fitohet duke u tërhequr, përkundrazi sa më shumë t'i tregojmë shoqërisë dhe pushtetit që janë një numër i madh aq më të lehtë kanë për ta pasur për ta fituar këtë betejë.

Nuk është njëlloj të përjashtosh nga shkolla një apo dy vajza me shami si të përjashtosh 20 apo 30 të tilla apo edhe më shumë, sepse si shoqëria por edhe politika bëhet më e ndjeshme në këtë drejtim kur ka një numër të madh.

- Cili është obligimi i ynë si shoqëri muslimanësh karshi vajzave që përjashtohen nga shkolla për shkak të mbulesës?

Atë që përmenda edhe më sipër tek masat që duhen marrë nga besimtarët dhe institucionet islame. Thjesht dua

të shtojë këtu që është e nevojshme që të aktivizohen në këtë drejtim edhe organizatat ndërkombëtare të drejtave të njeriut si dhe avokatë të zotë, për ta mbrojtur çështjen e shamisë në mënyrë permanente derisa ajo të marrë zgjidhje njëherë e mirë.

- Hoxhë i nderuar edhe njëherë ju falënderojmë për këshillat dhe realitetet që nxjerrët para nesh, duke treguar edhe njëherë që shamia dhe e drejta e saj janë pjesë e identitetit

tonë si musliman me fe, si shqiptarë me kombësi dhe si njerëz si lloj i krijesave. Lusim Allahun që ritet e Tij të madhërohen çdoherë në zemrat tona e të dalim para Allahut duke qenë Ai i kënaqur me ne.

Falënderimi me lavdërim i takon vetëm Allahut, ndërsa paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të Dërguarin e Tij, Muhamedin salAllahu alejhi ue selam, mbi familjen e tij, shokët dhe mbi të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Jurisprudencë/ HIXHABI

Nga hoxhë dr. Abdullah Nabolli

Lëvdatat i takojnë Allahut. Ne atë e lëvdojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Te Allahu mbështetemi të na mbrojë prej të këqijave të shpirtrave dhe të veprave tona. Kë e udhëzon Allahu askush nuk mund ta humbë dhe kë e humb Allahu askush nuk mund ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut të Vetëm dhe pa ortak dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.

Është me shumë rëndësi të flasim për hixhabin e femrave në një kohë kur ka rënë interesi i tyre për të; ose nuk e veshin fare, ose veshin një mbulesë e cila nuk është ajo që do Allahu i Madhëruar.

Prandaj dhe duke u nisur nga ky shkak do të trajtoj në këtë shkrim se si e sheh Islami veshjen në përgjithësi, të kundërtën e saj që është nxjerrja e bukurive trupore dhe lakuriqësia dhe ç'rregulla ka vënë Islami për veshjen e grave?

1- Veshja është mirësi e zbritur prej Allahut

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“O bijtë e Ademit, Ne ju zbritëm rroba që të mbulonin aurret tuaj dhe të zbulonin aurret tuaj; por, petku i devotshmërisë është më i miri. Këto janë disa shenja të Allahut, që ju të merrni këshillë.”** suretu El-Eraf: 26.

Allahu i Madhëruar njofton se i ka zbritur robëve të tij dy lloj veshjesh: veshje të jashtme dhe veshje të brendshme. Veshja e jashtme është mbulim për aurret për ta mbrojtur atë nga çdo ngacmim i jashtëm dhe është gjithashtu zbulim për njeriun sepse njeriu pa rroba është i shëmtuar. Kurse veshja e brendshme e cila është devotshmëria është më e mira veshje sepse ajo ruan zemrën dhe kushdo që kujdeset për veshjen e brendshme është kujdesur edhe për veshjen e jashtme dhe kushdo që nuk kujdeset për veshjen e brendshme nuk kujdeset për veshjen e jashtme.

2- Lakuriqësia është prej Shejtanit të mallkuar

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“O bijtë e Ademit, të mos ju mashtroni kurrsesi shejtani, ashtu siç nxori prindërit tuaj nga Xheneti, duke ua zhveshur rrobat për t'u dukur aurret!”** suretu El-Eraf: 27.

Shejtani kërkon t'i zbulojë njerëzit nga të dyja veshjet për të shtuar numrin e ndjekësve të tij sepse duke e zhveshur atë veshja e jashtme e fut në një shkatërrim të pafund dhe duke e zhveshur atë nga veshja e brendshme e le atë pa iman dhe besim. Shejtani është ai i cili e zhveshi Ademin alejhi selam siç thotë Allahu i madhëruar në

Kuran: **“Shejtani u pëshpëriti, për t'ua zbuluar aurret tuaj të mbuluar dhe u tha: “Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm.” Dhe iu betua atyre (duke thënë): “Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë!” Dhe i mashtroni me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbulua aurret dhe nisën të mbulohej me gjethe e Xhenetit”** suretu El-Eraf: 20-22.

Uehb bin Munebih (një tabiin që ka lajmëruar për shumë histori të marra nga ehli kitabi) tregon: “Veshja e Ademit dhe e Havasë që u mbulonte aurret ishte prej drite. Asnjëri prej tyre nuk shihte aurret dhe kur hëngrën nga pema u zbuluan aurret e tyre.”

Ky ajet shpjegon ajetin e lartpërmendur se veshja e brendshme është më e mirë se veshja e jashtme sepse Shejtani kur ua prishi veshjen e brendshme të Ademit dhe Havasë me gjynah iu prish veshja e jashtme dhe ranë në lakuriqësi.

3- Nderi i femrës nuk mund të ruhet pa mbulesë

Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: **“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), ta ruajnë nderin dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre”.** suretu En-Nur: 31.

Allahu e Madhëruar e përmend nderin e femrës bashkë me dy gjëra të tjera: ulja e shikimit dhe mos shfaqja e stolive që është mbulesa. Kjo do të thotë se nderi nuk mund të ruhet pa to dhe kjo bashkohet me fjalën tjetër të Allahut ku thotë: **“Mos iu afroni imoralitetit, se ai është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!”** suretu El-Isra: 32.

Allahu ka urdhëruar të mos i afrosh imoralitetit se kush i afrohet ka rënë në kurth dhe mos vënia e mbulesës është prej afrimit nga zinaja.

Këto janë gjykimet e Allahut të cilat i jep mbi bazën e dijes së Tij sepse ai është krijuesi dhe e di mirë se çka hedhur mbi njeriun. Allahu kur e krijoi mashkullin dhe femrën ka bërë për secilin dashuri kundrejt tjetrit në mënyrë që kjo tokë të popullohet duke ardhur pas çdo brezi një brez tjetër dhe nëse kjo dashuri apo anim nuk kufizohet me rregulla dhe norma, kalon në shfrenim dhe shëmti sikurse ka njoftuar Ai vetë.

Prandaj dhe në momentin kur shfaqja e bukurive të femrës apo zbulimi i saj nuk paraqet rrezik, e ka lejuar Allahu i Madhëruar siç thotë në Kuran: **“Të mos ua shfaqin stolitë e tyre, përveçse bashkëshortëve të tyre ose baballarëve të tyre, ose vjehërve të tyre, ose bijve të tyre, ose djemve të bashkëshortëve të tyre, ose vëllezërve apo djemve të vëllezërve të tyre, ose djemve të motrave a grave të tyre,**

ose atyre që i kanë nën zotërim (si skllave), ose shërbëtorëve që nuk kanë epsh ndaj femrave apo fëmijëve që nuk i dinë ngacmimet e femrave.” suretu En-Nur: 31.

4- Zbulimi i grave dhe shfaqja e bukurive të tyre trupore para të huajve është karakteristikë e kohës së injorancës (e shoqërive që nuk kanë njohur dritë besimi dhe rregullat e Allahut)

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“Qëndroni në shtëpitë tuaja e mos u zbuloni, ashtu siç zbuloheshin në kohën e injorancës!”** suren El-Ahzab: 33.

Mukatil bin Hajan (një prej komentuesve të kuranit në kohe ne tabiinëve) thotë: “Zbulimi i tyre ishte se femra hidhte mbulesën e kokës pas shpine pa e shtrënguar atë që të mbulonte varëset, vathët dhe qafën ku që të gjitha dukeshin prej saj. Ky është zbulimi i injorancës.”

E nëse këto gjëra Allahu i Madhëruar i ka konsideruar zbulim dhe ekspozim të bukurive trupore, atëherë ç'mund të thuhet për atë që bëjnë femrat sot kur lakuriqësia ka mbërritur në kulmin e saj?! Ne sot jemi më të zhytur në injorancë sesa ata që ishin para nesh.

5- Urdhri i Allahut në Kuran për mbulimin e grave

Duhet ditur se Allahu i Madhëruar i ka kërkuar grave dy lloje hixhabesh: hixhabi i shtëpisë dhe hixhabi jashtë shtëpisë.

a) Hixhabi i shtëpisë

Allahu i Madhëruar thotë në Kuran: **“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara), të ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme) dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme dhe le të hedhin mbulesën e kokës mbi xhepat e këmishave të tyre”.** suretu En-Nur: 31.

Fjala e Allahut [dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme]. Në këtë pjesë ajeti Allahu e ndalon femrën të nxjerrë jashtë stolitë e brendshme dhe e lejon të nxjerrë stolitë e jashtme dhe që janë dora dhe fytyra siç thotë Taberiu komentuesi më i madh i Kuranit (Allahu e mëshiroftë!).

Kurse në pjesën tjetër të ajetit [dhe le të hedhin mbulesën e kokës mbi xhepat e këmishave të tyre] Allahu e urdhëron femrën të mbulojë kokën duke e hedhur mbulesën e kokës mbi xhepat e këmishave të tyre që të mbulojë veshët, qafën dhe kraharorin dhe jo si në kohën e injorancës që e hidhnin mbi shpinë duke i zbuluar ato siç e thamë pak më lart.

Fjala “xhepat” është për qëllim vendi i prerë i rrobës që pritët për t'u futur

koka.

Fjala “këmishë” është për qëllim mbulesa e trupit ose ndryshe fustani siç e quajmë ne sot. Këmishat e asaj kohe ishin të gjera e jo me bel e të ngushta se ata e bënë copën dyfish hiqnin pjesën e futjes së kokës ose bënë xhepin siç e thamë më lartë dhe pastaj e qepnin anash.

Ky lloj mbulimi është quajtur mbulimi i namazit se profeti alejhi selam nuk e ka urdhëruar femrën kur fal namaz në shtëpinë e saj (jo në prezencën e të huajve) më shumë sesa të vërë mbulesën e kokës mbi këmishë siç thotë Profeti (alejhi selam): *“Nuk e pranon Allahu namazin e asaj femre me perioda (që ka arritur moshën e pjekurisë) veçse me mbulesën e kokës (të hedhur mbi xhepat e këmishave).”*

b) Hixhabi jashtë shtëpisë

Allahu i Madhëruar thotë në një ajet tjetër: **“O Profet, thuaju grave dhe vajzave të tua, si dhe grave të besimtarëve, që të lëshojnë xhilibabet e tyre përreth trupit. Kjo është mënyra më e përshtatshme që ato të njihen e të mos ngacmohen nga të tjerët. Me të vërtetë, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** suren El-Ahzab: 59.

Xhilibabi në këtë ajet është një rrobë e tretë që e kërkon Allahu i Madhëruar për gruan kur del jashtë përveç mbulesës së kokës dhe këmishës që ka kërkuar në ajetin e lartpërmendur dhe këtë ajet e quanin sahabët ajetin e hixhabit.

Xhilibabi ishte një copë pëlhure që hidhej nga koka gjer te këmbët siç thotë Begau, Kurtubiu dhe ibn Tejmije -Allahu i mëshiroftë të gjithë- bile edhe më e gjatë se këmbët se atëherë gratë nuk vishnin çorape siç thotë tregon Ummu Seleme, gruaja e Profetit (alejhi selam), se e kishte pyetur të dërguarin e Allahut kur po fliste për rrobën e burrave (që duhet të jetë sipër nyjeve), po gratë o i dërguari i Allahut? Profeti (alejhi selam) i thotë: “ta zgjasin (rrobën) një pëllëmbë.” Ummu Seleme i thotë: Kështu ajo zbulohet. Profeti (alejhi selam) i thotë: “Atëherë ta zgjasin një parakrah dhe të mos shtojnë më shumë.” E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

Ummu seleme (radiallahu anha) tregon gjithashtu për gratë kur zbriti ajeti i dytë dhe thotë: *“Kur zbriti ky ajet, gratë e ensarve kur dilnin ecnin qetë sikur të kishin mbi kokë ndonjë korb (pra nuk e trembnin atë nga qetësia e tyre në ecje) dhe mbi trup mbanin copa të zeza.”* E transmeton Abdurrazaku.

Në një transmetim tjetër thuhet se ajo ka thënë: *“Kur zbriti ky ajet, gratë e ensarve kur dilnin ecnin sikur të kishin*

(vijon në faqen 7...)

Aktualitet/ "FAMILJE E SHËNDOSHË- ATDHE I SHËNDOSHË"

Deri më tani 59 intelektualë dhe njerëz të njohur të skenës i janë bashkuar peticionit pro familjes dhe kundër homoseksualëve.

Në krye të listës është Adem Demaçi dhe më pas lista vazhdon me të tjerë intelektualë nga Shqipëria dhe Kosova.

Peticioni "Familje e shëndoshë-Atdhe i shëndoshë" vjen pas një parade të komunitetit LGBT në Tiranë.

"- Jo shkatërrimit të familjes shqiptare!

- Jo gjeesteve që inkurajojnë cenimin e unitetit të familjes dhe shoqërisë!

- Jo përkrahje publike modeleve që e shndërrojnë shoqërinë tonë në Sodomë dhe Gomorrë!

Sepse familja është embrioni i çdo shoqërie dhe i çdo qytetërimi. Familja është shoqëria në miniaturë. Familja fillon me fëmijët. Familja është mjedisi i parë, ku njeriu duhet të mësohet të krijojë mirësi. Paprekshmëria e familjes garanton sigurinë e shoqërisë së madhe njerëzore. Çdo doktrinë sociale, që përpiqet të rrënojë familjen është e papranueshme dhe përveç kësaj, e pazbatueshme. Të rritesh në një familje vërtet të shëndetshme – ky është suksesi i sukseseve. Vartësia e jetës familjare e bën më të moralshëm njeriun. Një popull që nuk duron padrejtësitë në jetën familjare, nuk mund t'i kryejë ato në jetën shoqërore. Sepse familja është kristali i një shoqërie.



Populli shqiptar ka përjetuar mjaft mjerime, luftra, fatkeqësi e pushtime të huaja. Por të gjitha plagët ne i kemi shëruar dhe të gjitha fatkeqësitë i kemi kaluar, duke u mbështetur gjithnjë në moralin e lartë të një familje të bashkuar. Vlerat tona të familjes kanë qenë gjithnjë ato që na kanë mbajtur të qëndrojmë në këmbë me krenari e dinjitet. Ky ka qenë sekreti i qëndresës sonë në përballimin e vështirësive që s'na i kurseu fati dhe kështu ka për të qenë në jetë të jetëve. Familja shqiptare është vlerë e shenjtë, e paprekshme!" thuhet në peticion.

LISTA E INTELEKTUALËVE

1. Prof. Adem Demaçi -Prishtinë
2. Prof. Milazim Krasniqi – Prishtinë
3. Kim Mehmeti – Shkup
4. Prof. Dr. Xhevat Lloshi

5. Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu
6. Prof. Dr. Hasan Çipuri
7. Prof. dr. Murat Gecaj
8. Prof. dr. Pajtim Ribaj
9. Prof. dr. Aleksandër Kocani
10. Prof. dr. Shyqyri Rreli
11. Prof. dr. Josif Papagjoni
12. Prof. dr. Stefan Çapaliku
13. Prof. dr. Ahmet Osja – Shkodër
14. Prof. Dr. Jashar Demiri-psikologji
15. Prof. Dr. Ejub Çota
16. Dr. Agron Tufa
17. Dr. Faruk Borova
18. Dr. Baki Dervishi
19. Dr. Agron Gjekmarkaj
20. Dr. Zef Gjeta
21. Dr. Angjelin Shtjefni
22. Dr. Fabian Zhilla
23. Dr. Arian Galdini
24. Dr. Agim Baçi
25. Dr. Çelo Hoxha
26. Alush Saraçi

27. Lefter Çipa
28. Sidrit Bejleri
29. Shpëtim Saraçi
30. Julian Deda
31. Albano Bogdo
32. Jonida Maliqi
33. Luljeta Lleshanaku
34. Vedat Ademi- këngëtar
35. Rexhep Çeliku
36. Armand Bora
37. Petrit Ruka
38. Frrok Çupi
39. Lazër Stani
40. Aleksandër Çipa
41. Alfred Lela
42. Agim Doçi
43. Ilir Kulla
44. Vladimir Beja
45. Salvador Kaçaj
46. Patrik Sadikaj
47. Roland Zili
48. Fitim Zekthi
49. Bardhyl Fico
50. Dr. Rezart Ajazi
51. Frano Kulli
52. Jozefina Traboini
53. Migena Barolli
54. Redi Shehu
55. Afrim Bilali
56. Bardhyl Selimi
57. Ramush Lekaj
58. Ermal Mamaçi

Të gjithë ata që dëshirojnë t'i bashkëngjiten kësaj nisme të vizitojnë faqen në FB si më poshtë:

https://www.facebook.com/pages/Familje-e-sh%3C%ABndosh%3C%AB-Atdhe-i-sh%3C%ABndosh%3C%AB/637598913001401?notif_t=fbpage_fan_invite

mbi kokë ndonjë korb prej rrobave." E transmeton Ebu Daudi dhe e saktëson sheikh Albani.

Pra, shihet në këto përshkrime se hixhabi i tyre ishte një xhilibab i gjatë nga koka deri te këmbët mbi mbulesën e kokës dhe mbi këmbësh dhe tani lind pyetja a mund ta bëjë sot një pardesy punën e rrobës së tretë pra të xhilibabit të atëhershëm?

Përgjigjja është se mundet ta bëjë punën e tij nëse plotëson kushtet e xhilibabit të cilat janë:

- 1- i gjerë siç ishte xhilibabi
- 2- nëse gratë veshin çorape dhe këpucë nuk bën problem nëse nuk rrëshqet mbi tokë si xhilibabi
- 3- nëse koka mbulohet me një mbulesë të brendshme për të mbledhur flokët dhe pastaj me një mbulesë të jashtme që derdhet mbi pardesy në të njëjtën mënyrë siç derdhet xhilibabi, mundet të mjaftohemi me të dhe pardesynë që rri mbi supë. Në disa vende përdorin një lloj mbulesë për kokën që quhet Burnus e cila hidhet mbi kokë dhe derdhet mbi kraharorin

e mbuluar me pardesy deri në majat e gishtave të dorës për të shmangur mangësitë që le një pardesy që rri mbi supë i cili në ndryshim nga xhilibabi ndan pjesët e trupit nga njëra tjetra dhe është me bel.

Mund të thojë dikush se pse kjo lloj veshje për gruan?

Përgjigjja: Profeti (alejhi selam) na njofton për një realitet që e di vetëm Allahu dhe nuk e di kush tjetër: **"Gruaja është auret dhe kur del, Shejtani e ngre kokën nga ajo"** E transmeton Tirmidhiu dhe e saktëson sheikh Albani.

Komentuesit e haditheve thonë: Kur gruaja del, shejtani e ngre kokën për ta mashtruar atë ose për të mashtruar të tjerët me të duke e hedhur njërin prej tyre ose të dy në sprova.

6- Prej shenjave të orës së fundit të dynjasë mos interesimi i grave për mbulesën

Profeti (alejhi selam) thotë: **"Dy lloje njerëzish prej banorëve të Zjarrit nuk i kam parë akoma: disa njerëz që kanë kamxhikë si bishtat e lopëve**

rrahin me to njerëzit dhe disa gra të veshura por lakuriq, të mënjauara dhe mënjauese dhe kokat e tyre si gungat e deveve. Nuk do të futën në Xhenet dhe nuk do t'ia ndjejnë erën edhe pse era e tij ndihet në largësi të mëdha." E transmeton Muslimi.

Komentuesit e haditheve kanë dhënë tre mendime rreth kuptimit të fjalës së profetit alejhi selam [gra të veshura por lakuriq]:

- 1- të veshura me mirësitë e Allahut dhe të zhveshura nga falënderimi
- 2- veshin një pjesë të trupit dhe zbulojnë një tjetër
- 3- veshin rroba të holla që nuk mbulojnë.

Mendoj se ai që e ka dhënë mendimin e parë nuk ka paramenduar se mund të vijë një kohë kur gratë do të zhvishen.

Ky hadith ka lidhje me një hadith tjetër ku Profeti (alejhi selam) njofton: **"Nuk ka për të ardhur ora e fundit e dynjasë derisa të bëhet zinaja në mes të rrugës si gomerët."** E transmeton Bezari dhe e saktëson sheikh Albani.

Njerëzit nuk mund të shkojnë deri

në këtë gradë duke qenë gruaja e veshur me petkun e pastërtisë por me lakuriqësi.

7- Kur mund ta heqë gruaja rrobën e tretë, xhilibabin?

Allahu i Madhëruar në Kuran thotë: **"Gratë e vjetra, që nuk shpresojnë më të martohen, nuk është gjynah ta heqin mbulesën e jashtme, por jo duke i treguar stolitë e tyre. E, nëse përmbahen, është edhe më mirë për ato. Allahu i dëgjon dhe i di të gjitha."** Suretu En-Nur: 60.

Imam Taberiu komentuesi më i madh i Kuranit thotë: Allahu ka pasur për qëllim në këtë ajet heqjen xhilibabit që është mbi mbulesën e kokës dhe këmbësh.

Pra, gratë kur të arrijnë moshën e pleqërisë mund të dalin me shami dhe fustan kurse grave të tjera nuk u lejohet kjo gjë.

Dhe së fundi i lutemi Allahut të na japë pastërti në veshje dhe në zemër se pa këto të dyja nuk shpëton njeri ditën kur njerëzit dalin para Allahut, Zotit të botëve! Amin!

Bar Restorant Piceri "Ishulli Luanëve"



Në dalje të Tiranës, larg zhurmave të përditshme, në qetësinë dhe në ajrin e pastër, do të shijoni gatime tradicionale dhe hallall të guzhinës sonë.

Menu e pasur dhe një pamje piktoreske e lumit Erzen, e cila do t'ju mahnisë.

Ju mirëpresim!



Adresa: Rruga nacionale
Tiranë-Durrës, Ndroq, km 17

Mobile: 00355 682153105

PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e lindjes!



Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
Hurra arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
Kohël bimor për sytë etj.

Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
Cel: 0672812607 / 0672821589

www.produktenatyrale.com
Email: agimballa@hotmail.com

